

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit, Loti 3 “Poli i Zhvillimit turistik në Sarandë - Faza 1.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit: 379,176,241.58 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të LPP, nenin 39, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve e njëpasnjeshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 10091/2009: “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

-
- Kontratën/at e Sipërmarrjes
 - Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore
 - Situacioni përfundimtar
 - Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila përfshin kategoritë e mëposhtme.

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P -	1.	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P -	2.	D	Ndërtime civile dhe industriale
N.P -	3.	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
N.P -	4.	A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
N.P -	5	A	Punime nentoksore, ura e vepra arti
N.P -	7.	A	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.
N.P -	11.	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
N.P -	12.	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

N.S –	1.	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S –	2.	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
N.S –	3.	A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë levizëse, transportues)
N.S –	4.	D	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
N.S –	6.	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
N.S –	8.	B	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
N.S -	12.	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S -	13.	A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

N.S - 14.	A	Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj
N.S - 18.	A	Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gërmimi në tokë	- Gërmim shkëmbi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkëmb, ne themele gjerësi >2 m, me shkarkim ne toke	0-20 mln leke	2,416,539.88 leke
N.P-2 D	Ndertime civile dhe industriale.	- Struktura monolite betoni C 25/30 - Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37 - Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m - Solete me traveta t=30cm - Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 - Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m	100-200 mln leke	134,489,999.06 09 leke
N.P-3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	- Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	0-20 mln leke	3,161,875.50 leke
N.P-4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	- Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese stabilizant t=15cm - Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm,	0-20 mln leke	14,659,056.28 leke

		<p>perhapur e ngjeshur me makineri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri 		
N.P-5 A	Punime nentoksore, ura e vepra arti	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 20/25 - Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka 	0-20 mln leke	3,988,070.85 leke
N.P-7 A	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	<ul style="list-style-type: none"> - F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm - F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm - F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 - FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16 - FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 - FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 - FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 - F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm - Tub kanalizimi pvc Ø 160 - F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit 2" - F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit 2 1/2" - F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit 4" - F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit, 90* 4" - F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit, 90* 2 1/2" - F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit, 90* 2" - F.v Ti celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit 4" - F.v Ti celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetimit 2 1/2" 	0-20 mln leke	9,098,895.25 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - F.v Reduksion celik I zinguar 2 1/2"-2" - F.v Hollandez celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim 4" - F.v Hollandez celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim 2" - V. Rezervuar uji vertikal celik I zinguar ose PE 160x260 cm me volum 5 m³ - F.V Galexhant mekanik 2" - V. Galexhant elektrik 		
N.P-11 A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve e linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	<ul style="list-style-type: none"> - F.V tub plastmasi Ø 18-21mm - F.V tub plastmasi Ø 31-36mm - F.V tub plastmasi Ø 22-26mm - F.V Kutiderivacioni plastm - F.V. Sirene e brendshme audio vizive - F.V. Sirene e jashtme - F.V.konstruksione te vogla elektrike - F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 1x185mm, Cu (paneli kryesor) - F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (kuadri 1, Katit Perdhe) - F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Kuatri 2, Katit Perdhe)) - F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Kuatri 2, Katit Nentoke) - F.V. Kuadri kryesor Kk,metalik, komp.me kit zbara 250A & aksesori J/m, me dim 850/2000/400 mm. IK08 me porte me xham. - F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj. - F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,;K.Z. FG7-OR ; S=3x4 mm² - F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,;K.Z. FG7-OR ; S=3x2.5 mm² - F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,;K.Z. FG7-OR ; S=3x2.5 mm² 	0-20 mln leke	10,506,193.47 leke

		<p>(lidhja me prizat e fuqise)</p> <ul style="list-style-type: none"> - F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,;K.Z. FG7-OR ; S=3x1.5 mm² - F.V. Frut çeles 1 polare , 10A - F.V. Prize " Schucko " 16A te bardha - F.V. Kuti per celesa e priza 3-module, suport , kapak & tapa ne mure - F.V. Kuti shperndarese b/m. me kapak PT-2-4 dim. 150*100*50 mm - F.V. Rele me dy gjendje Finder, In=16 A; Un=250 V - Kabell elektrik 2x1 - Panel LED 48W 4500K 600X600 IP20 - F.V Zbritje shkalle - Ndricules Emergjence Sirio LED 11W (me autonomi) - V. Transformator i thate me rezine 20/0.4kV Sn=250kVA - V. Cele TM Hyrje-Dalje Un=24kV, 20kA - V. Cele TM per mbrojtje transformatori me celes me gas SF6 Un=24kV, 20kA - FV.Kabell TM XLPE .AL (1x50) mm² (Ura TM) - F.V. Kabell AL, TU, 1x240 mm² (Ura TU) - F.V. Kapikorda sy - TM, 20 kV, CU /AL, S = 25-50 mm² - F.V. Kapikorda sy- TU qaf gjate CU /AL, S=240 mm² - 5-6W LED IP20 150x4xh=45 - Ndricules tip plafoniere, emergjence,1x18w,IP65 		
N.P-12 A	Punime te inxhinerise mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 7.0 km - F.V. Dhe humusore 	0-20 mln leke	2,628,851.53 leke
N.S-1. A	Punime per prishjen ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Heqje dritare ekzistuese - Heqje dyer ekzistuese 	0-20 mln leke	1,421,235.62 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Prishje veshje me gure ekzistuese jashte me pastrim - Prishje suva ekzistuese muri brenda me pastrim 		
N.S-2. A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaneri, mirembajtja e tyre	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami, Type 1469, IP-65 - F.V. Indikator tymi jonik-optik-temperature - F.V. Kabell Fire Alarm FG100M1, 3X1.5mm - F.V. Instrumenta mates A,V - F.V Fikese zjarri me pluhur - F.V Buton sinjalizimi i zjarrit 	0-20 mln leke	1,042,916.07 leke
N.S-3. A	Impiante ngritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese,	<ul style="list-style-type: none"> - V. Ashensor per 6 persona 	0-20 mln leke	118,750.09 Leke
N.S-4. D	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	<ul style="list-style-type: none"> - Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 - Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm - Veshje me pllake majolike - Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi - Plintuse grez h = 10 cm - Termoizolim solete 10-20 cm me polisterol kompakt - Shtrese me pllaka grez porcelanato - Shtrese avullizoluese gjeotekstil - Pedane druri (binare+derrase+parket) - Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 3 k katrama - Vetrato xhami i temperuar - F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. 	101-200 mln leke	105,276,293.11 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Dritare d/alumini dyfi xh. - Boje hidroplastike - Boje hidroplastike cilesi e larte - F.V. Tapete gome izolues 24kVA 		
NS-6 A	Sinjalistika rrugore ndriçuese.	<ul style="list-style-type: none"> - F.V Tabele dalje emergjence - F.V. Tabela Sinjalizuese - F.v. Tabele drejtkëndore (tregimi)(AxB) e zvogëluar 40x60 	0-20 mln leke	34,577.28 leke
NS-8 A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	<ul style="list-style-type: none"> - F V konstruksione metalike te perbera - F V konstruksione metalike te thjeshta - Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm - F.V Zbritje shkalle 	21 -50 mln leke	15,729,398.86 leke
N.S-12. A	Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesor B/M, me dim - F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V - F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=32A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V - F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=10A/1P, kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V - F.V. Ventilator me valvol moskthimi per 90 m³/h - V. Grup elektropompash per furnizimin me uje Q=8 l/s : H=60m - V. Panel diellor me 2 kolektor 200x100 cm dhe boiler me volum V=300 litra - Tub fleksibel me termoizolim ø250 - Tub fleksibel me termoizolim ø150 - Tubacione dhenie ajri per vendosje brenda ambienteve, prej shkume poliuretani te zgjeruar, me dendesi 48Kg/m³, (panel sandwich), e veshur me flete alumini brenda/jashte - 80/80 micron, bashke me aksesoret per prodhimin montimin dhe fiksimin 	0-20 mln leke	14,004,273.50 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Grila 100x15 2R - Grila 80x10 2R - Aksesore montimi si fasheta , qafore , silikon etj. - Tub bakri I termoizoluar me diameter 6.35 (1/4") - Tub bakri I termoizoluar me diameter 9.52 (3/8") - Tub bakri I termoizoluar me diameter 12.7 (1/2") - Tub bakri I termoizoluar me diameter 15.9 (5/8") - Tub bakri I termoizoluar me diameter 19.1 (3/4") - Tub bakri I termoizoluar me diameter 22.2 (7/8") - Tub bakri I termoizoluar me diameter 25.4 - Tub bakri I termoizoluar me diameter 28.6 (1"1/8) - Tub bakri I termoizoluar me diameter 34.9 (1"3/8) - Tub bakri I termoizoluar me diameter 31,8 (1"3/8) - Tub plastik Ø32 per kondesatin - Tub plastik Ø50 per kondesatin - Rakorderi PP per kondesatin - Deviator Bakri KHRQ22M20T ose e ngjashme - Deviator Bakri KHRQ22M29T9 ose e ngjashme - Deviator Bakri KHRQ22M64T ose e ngjashme - Deviator Bakri KHRQ22M75T ose e ngjashme - Deviator Bakri BHFQ22P1007 per lidhjen e pajisjes se jashtme ose e ngjashme - Gaz R410A 		
--	--	--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Punime montimi per sistemin e ventilimit - Punime montimi (shtrimi i tubave te bakrit, tubave plastik per kondesatin, montim deviatore bakri, shtrimi i kabellave elektrik, mbushje me gaz) - Punime per kolaudimin dhe ndezjen e impjantit - V.Tabele basketbolli - V.Rrjeta e volejbollit+shtyllat per vendosjen e rrjetes - F.V. Tub dhe rakorderi ujesjellesi PPR d=16mm, Pn 16 - F.V Rakorderi PE-Xa (brryla, reduksion etj) - F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 50 mm - F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 110 mm - Panel LED 36W 4000K 600x600 IP20 - Montim Lavaman i varur (65 x 51) cm + mishelator - Montim Bolier i ujit te ngrohte sanitar, kapaciteti 80 lit. - F.V Parthenocissus tricuspidata 		
N.S-13. A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Priza kompjuterike, TIP RJ - 45 cat5 - F.V. Kabllo rrjeti, Tip FTP-cat5 	0-20 mln leke	1,303,887.32 leke
N.S-14. A	Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiofoni TV etj	<ul style="list-style-type: none"> - Fiber Optike SM 2 kanale - Percjelles telefonie me 1 kopje, 2x0.5 mm2 - Kabell telefonie me 30 kopje 	0-20 mln leke	137,211.95 leke
N.S-18. A	Punime topogjeodezike.	<ul style="list-style-type: none"> - Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik 	0-20 mln leke	0 leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) inxhinier Elektrik
- 1 (nje) inxhinier Transporti

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislati për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Inxhinier Ndërtimi	Punime prishje Punime shtresash Punime dyer e dritare Punime dheu Punime hekur betoni Punime betoni e beton armeje Punime murature tulle Punime tavani dhe suvatimi Punime bojatisje Punime hidroizolimi e catie Punime nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave Punime te ndryshme
--------------------	---

Inxhinier Hidroteknik	Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje Analiza jashte liste
Inxhinier Mekanik	Analiza jashte liste instalime hidro-sanitare dhe ngrohje
Inxhinier Mjedisi	Punime per transportin dhe sistemimin e vendit atje ku jane kryer punime
Inxhinier Elektrik	Punime instalime per ndricim Punime te ndryshme, elektrike dhe sinjalistika Punime analiza jashte liste
Inxhinier Gjeodet	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
Inxhinier Transporti	Punime shtresash, punime germimi e transporti

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i

ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 60 persona për periudhën, tremujtoje nga data e zhvillimit te procdures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,
- Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39 pika 6/ç te VKM nr.285/2021 “Per rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Numti i punonjësve eshte percaktuar bazuar tek faktorët si, volumet dhe kategoritë e punimeve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit te tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e ketij kriteri, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike jane bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Nga llogaritja e oreve te punes per te gjithë zerat e punimeve te preventivit sipas manualit te cmimeve per fuqine puntore konkludojme si meposhte:

Total ore pune= 186,660.77 ore

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 186,660.77 ore/8 ore= 23,332.60 dite pune

Dite pune gjithesej= 18 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 396 dite pune

Numri I fuqise puntore = 23,332.60 dite/396 dite= 58.92 puntore.

Ne menyre te permbledhur numri I fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshe min 60 puntore.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi, ose qira, ose kontrate furnizimi.

Mjetet	Sasia	Statusi
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 12 ton	2cope	në pronësi ose me qira
Grejder	1 cope	në pronësi ose me qira
Autobitumatrice	1 cope	në pronësi ose me qira
Asjaltoshtruese	1 cope	në pronësi ose me qira
Rul gome hekur mbi 12 tone	1 cope	në pronësi ose me qira
Rul Hekur- Hekur 4-6 tone	2 cope	në pronësi ose me qira
Ekskavator me goma 0.25m3	1 cope	në pronësi ose me qira
Kamioncina 5 ton	3 cope	në pronësi ose me qira
Minieskavatore	2 cope	në pronësi ose me qira
Autobot uji	1 cope	në pronësi ose me qira
Autobetoniere	1 copë	në pronësi ose me qira
Depozite uji (5000 litra)	1 cope	në pronësi ose me qira
Auto-Pompe betoni	1 copë	në pronësi ose me qira
Autovinç deri 5 ton	1 cope	në pronësi ose me qira
Kompresor	1 cope	në pronësi ose me qira
Matrapik	1copë	në pronësi ose me qira
Gjenerator	1 copë	në pronësi ose me qira
Vibrator thellesie	1 cope	në pronësi ose me qira
Vobrator siperfaqsor	1 cope	në pronësi ose me qira
Vinc teleskopik	1 cope	në pronësi ose me qira
Vinc me kosh	1 cope	në pronësi ose me qira
Elektrosaldatrice	1 cope	në pronësi ose me qira

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Numri i makinerive është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për secilën proces pune është përcaktuar lloji i makinerive dhe ditët e punës përkatëse. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira /kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI I MJETEVE SIPAS ZERVE NE PREVENTIV

Mjetet	Sasia	Statusi	Zerat e punimeve per mjetet
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 12 ton	2cope	në pronësi ose me qera	Per transportin e materialeve te dala nga prishjet, germimi dhe per transportin e materialeve te ndryshme.
Grejder	1 cope	në pronësi ose me qera	Per hapjen dhe shtrimin e materialeve si cakull e stabilizant
Autobitumatrice	1 cope	në pronësi ose me qera	Per sperkatjen e stabilizantit dhe binderit

Asjaltoshtruese	1 cope	në pronësi ose me qera	Shtim binderi dhe asfaltbetoni
Rul gome hekur mbi 12 tone	1 cope	në pronësi ose me qera	Per ngjeshjen e nenshtresave dhe shtresave te cakullit e stabilizantit
Rul Hekur- Hekur 4-6 tone	2 cope	në pronësi ose me qera	Per ngjeshjen e shtresave te binderit dhe asfaltbetonit
Ekskavator me goma 0.25m3	1 cope	në pronësi ose me qera	Punime germimi seksion i lire dhe seksion i detyruar, per vepra arti, KUB, KUZ etj. (Per kategorite e tokes joshkembore)
Kamioncina 5 ton	3 cope	në pronësi ose me qera	Transport materiale ndertimi per furnizim ne objekt, dhe transport materialesh te dala nga prishjet e germimi deri 5.0 km
Minieskavatore	2 cope	në pronësi ose me qera	Per punimee germimit te seksione te vogla per ujesjelles, per KUZ(me diameter te vogël) per linjat e infrastruktures nentokesore
Autobot uji	1 cope	në pronësi ose me qera	Per te kryer testet ne punimet hidrosanitare dhe pastrimet ne solete para hidroizolimit
Autobetoniere	1 copë	në pronësi ose me qera	Per transportin e betonit nga impianti i prodhimit deri ne veper.
Depozite uji (5000 litra)	1 cope	në pronësi ose me qera	Per lagjen e amjenteve te brendeshme pas prishjes se suvatimeve, pllakave dhe pergatitjen e llaceve te ndryshme te suvatimit
Auto-Pompe betoni	1 copë	në pronësi ose me qera	Per hedhjen e betonit nga autobetoniera deri ne veper (strukturat monolite b/arme)
Autovinç deri 5 ton	1 cope	në pronësi ose me qera	Per ngritjen e materialeve te ndertimit, montimin e shtyllave te ndricimit
Kompresor	1 cope	në pronësi ose me qera	Per pastrimin e pluhurave mbas procesit

			te prishjeve te suvatimeve, heqjes se pllakave, heqje te detyrve e dritareve etj
Matrapik	1 copë	në pronësi ose me qera	Per prishjen e pllakave te dyshemeve dhe nenshtresave te betonit te varfer ne soleta e dysheme
Gjenerator	1 copë	në pronësi ose me qera	Per prodhimin e energjise elektrike qe nevojitet per montimin e konstruksioneve metalike ne fasade, kangjella e tj
Vibrator thellesie	1 cope	në pronësi ose me qera	Per ngjeshjen e betoneve ne traret, arkitraret dhe kolonat betonarme
Vobrator siperfaqsor	1 cope	në pronësi ose me qera	Per ngjeshjen e shtresave te betonit te varfer ne dyshemete e nertesave
Vinc teleskopik	1 cope	në pronësi ose me qera	Per furnizimin me materiale te punimeve te soletes
Vinc me kosh	1 cope	në pronësi ose me qera	montimin e ndricuesve.
Elektrosaldatriçe	1 cope	në pronësi ose me qera	Per perpunimin e konstruksioneve metalike apo saldime te ndryshme etj.

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi:.. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që

operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve janë hartuar nga projektues i licencuar dhe janë pjese e pandare e DST. Në cdo rast nëse janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecantë pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	60
2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë	pikët	10
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët	15
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët	10
5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët	5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi [0 - 60] pikë

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –10 pikë]

Argumentimi: Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

- Punime për ndërtimin e objekteve të reja administrative, arimore dhe social kulturore me sipërfaqe ndërtimi jo më pak se 9,600 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit.

Formula e përlogaritjes së mesatares:

$$VS = \frac{\sum VS}{5 \text{ (vite)}}$$

VS Volumi specifik për përlogaritjen e kriterit

$\sum VS$ Shuma e volumnit specifik për 1 ose disa kontrata

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 mujore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet situacioneve përfundimtare, aktit të kolaudimit sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, dorezimit të detyrueshem të informacionit të përmbledhur

sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perlllogartje.

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–15 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do të ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancinë sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Argumentimi: Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubrikën specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës. Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se 9,600,540.8 leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e te levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria ne kantier/shëndeti, impakti ne mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria ne kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe

kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 9,600,540.8 leke pa tvsh.
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 9,600,540.8 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantiër më të lartë se vlera 9,600,540.8 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantiër/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar në kantiër/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia në punime: siguria në kantiër/shendeti, impakti në mjedis dhe social” nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia në punimet e kryera: siguria në kantiër/shendeti impakti në mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

M_o – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (R_{rm}) – Rritje e mundshme

$$M_o = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$$

$$PR = 200\% M_o$$

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia në punimet e kryera: siguria në kantiër/shendeti impakti në mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknike, preventivi me zerat e punimeve janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi me objekt: “Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit, Loti 3 “Poli i Zhvillimit turistik në Sarandë - Faza I” do te pranohen edhe ekuivalent